

## TRASHËGIMIA (pjesa 1)

### Gatishmëria vs. Lumturia

Po fillojmë një seri të re të quajtur “Trashëgimia”. Dua të shikojmë diçka për të cilën shumë njerëz as nuk duan të flasin. Çfarë ndodh pasi vjen momenti të ikim nga kjo jetë? Çfarë duam të lëmë pas? Çfarë trashëgimie?

Shumica e njerëzve, kur përmenden biseda të tilla, thonë, “*Qoftë larg, qoftë larg,*” dhe kapin ndonjë gjë me dorë, dru ose gur. Tronditen kur flasin për këto gjëra.

Dua të të sfidoj ty që të mendosh për këtë gjë:

#### **Çfarë Trashëgimie Do Që Të Lësh Pas?**

Çdo njeri ka dëshirë të lërë pas diçka.

Unë për vete s’kam frikë të flas për vdekjen sepse nga ajo që kam parë dhe dëgjuar, nga 100 veta, të 100-të vdesin. Nuk ngel njeri pas, mos një ditë, një tjetër, të gjithë do të vdesim.

Në jetë kam bërë dy funerale. Kam bërë shumë dasma, por dy funerale dhe është moment i sikletshëm. Kam drejtuar funeralin e gjyshes dhe të babait të një mikut tim.

Ka funerale që ke dëshirë të dëgjosh se çfarë ka lënë pas filani, nuk po flas për gjëra materiale. Tani, mirë do ishte nëse kanë lënë ndonjë gjë të tillë. Por më shumë për kujtimet, për çfarë do të mbahet mend ai person.

(shembull: Dionisi te “Ferma VIP”, tha se ishte në burg për një arsye dhe ishte shumë trishtim i madh.)

Dikush harrohet kur vdes dhe kur bie në burg.

Është e vërtetë që në shumicën e rasteve, nuk ngelin shumë gjëra pas nga jeta e dikujt dhe harrohet shpejt.

Prandaj dua që këto 4 javë të shikojmë si ta jetojmë jetën, në mënyrë që të lëmë pas një trashëgimi të pasur, plot me vlera, plot me kujtime që vazhdojnë disa breza pas nesh. Ndiqe serinë si lider, si prind dhe si ndjekës i Krishtit.

Shumica prej jush jeni të rinj, ndoshta as që doni të bëni biseda të tilla, por mendoj që është super gjë që t’i dini këto që nga fillimi sepse keni më shumë kohë për t’i ndërtuar. Për të tjerët që janë moshë e madhe, nuk është seri për t’u ndjerë keq, por për të parë a ka diçka që duhet përmirësuar, që duhet bërë akoma.

Sepse shiko, 40 ditë pas ringjalljes së Krishtit, filloi kisha e parë dhe ishin disa mijëra. Por sot në botë janë miliona e miliarda. Ata që morën besimin te Krishti, e trashëguan brez pas brezi.

Shqipëria para 34 vitesh nuk kishte asnjë të krishterë, se ishte vend komunist, si Koreja e Veriut sot. Por pas tridhjetë e disa vitesh ka mbi 300 kisha ungjillore dhe mijëra që besojnë Krishtin Jezus si Zot dhe Shpëtimtar dhe urojmë që kjo trashëgimi do të vijë duke u shtuar.

Sot, kjo që do të ndaj është si hyrje për serinë. Në fund do të theksoj diçka kyçe. Pasazh kyç që do të lexojmë sot nga Psalmi 112.

**Psalmi 112:1** “Lum njeriu që ka frikë nga Zoti dhe gjen një gëzim të madh në urdhërimet e Tij.”

**Psalmi 112:2** “Pasardhësit (fëmijët) e tij do të jenë të fuqishëm mbi tokë, brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar.”

Kush nga ju prindër do ta donte këtë për fëmijët e vet? Po për ty që s’je akoma prind, a do të doje të thuhej kështu për ty dhe për familjen që do të kesh? *Fëmijët e tu do të jenë të fuqishëm dhe të suksesshëm kudo që të jenë dhe do të jenë të bekuar?*

Sepse shiko, nëse unë dhe gruaja ime kemi sukses në gjërat që po bëjmë në jetë, por nëse fëmijët tanë nuk e ndjekin Krishtin, kemi dështuar si familje. Madje nëse arrijmë të kemi shtëpi e prona, apo makina e gjëra dhe nëse fëmijët tanë s’jetojnë me vlerat sipas Shkrimit, ne kemi dështuar.

Sigurisht që mund ta ngushëllojmë veten, “*Po tani ata janë mbi 18 vjeç, e kanë zgjedhur vetë se çfarë duan të bëjnë.*”

Por nëse kisha jonë bëhet kisha më e madhe në Shqipëri dhe djemtë e mi nuk e nderojnë emrin e Zotit, unë jam dështak.

Imagjino premtimin më lart: *Ti, unë, ne, të jemi pjesë e një brezi të bekuar, familjet tona dhe fëmijët tanë të jenë të bekuar dhe të fuqishëm. A s’do ishte fantastike?*

**Psalmi 112:3** “*Në shtëpinë e tij ka bollëk dhe pasuri dhe drejtësia e tij vazhdon përjetë.*”

Në shtëpinë e tyre do të ketë bollëk, dhe drejtësia do të vazhdojë. Sa? Një ditë, ca vite? Përjetë! Të lëmë një trashëgimi që vazhdon ndër breza.

**Psalmi 112:4** “*Drita lind në terr për ata që janë të drejtë, për njeriun e dhembshur, të mëshirshëm dhe të drejtë.*”

Ata janë të dhembshur, janë bujarë, janë të mirë, janë të drejtë, janë si shpirt. Kujdesen për të tjerët, nuk bëhen palë me vlerat që kanë të tjerët vërdallë, por e kanë mendjen tek të tjerët.

**Psalmi 112:6** “*sepse nuk do të lëvizet kurrë; i drejti do të kujtohet gjithnjë.*”

Do të kujtohet gjithnjë, nuk do të harrohen gjërat që kanë lënë pas ata.

Si duket? A do të doje të lije këtë lloj trashëgimie?

Por....

Shiko, të ndaj një detaj me ty. Quhet problemi i brezit të tretë. Sepse është shumë e vështirë të pasosh diçka deri te brezi i tretë. Është vështirë ta ruash trashëgiminë, besimin, përtej brezit të tretë. Madje në një studim për bizneset rezultoi se vetëm 10% e atyre që trashëgojnë një biznes nga prindërit ose gjyshërit, e mbajnë pas brezit të 3-të.

**Brezi i Tretë = 10%**

Brezi i parë e fillon biznesin, me vështirësi, por e ngre. Gjyshi filloi një biznes me pak lekë, shumë ide, shumë punë dhe e ngre fuqishëm.

Brezi i dytë e zhvillon dhe e mirëmban, e ruan me kujdes atë që ka trashëguar. Brezi i tretë e shkatërron dhe e bën rrush e kumbulla, sepse është shumë e vështirë për ta mbajtur gjallë frymën, vlerat, ëndrrën që kishte ai i pari që e filloi atë gjë.

Dhe e di pse është e vështirë?

Dhe kjo vlen edhe për ne. Ne jemi brezi i parë i kishës. Ju njiheni si lidera.

**Nëse je pjesëtar i kishës, je... si vazhdon, je lider!**

Brezi i parë ka lidera të fortë. Fillojnë gjëra të reja, nuk kanë frikë. Sepse shikojnë potencialin se çfarë mund të sjellë koha, munda, e dhjeta e investuar.

Brezi i dytë, marrin shumë gjëra të gatshme.

Dhe urojmë që brezit të dytë do t'i lëmë një ndërtesë të tyren dhe shërbesa dhe festime të ngritura nga brezi ynë, kështu që fëmijët tanë do kenë shumë gjëra gati.

Dhe synimi i tyre mund të kthehet se si ta mirëmbajnë, si ta ruajnë atë që kanë. Por për shkak se e kanë më shumë mendjen tek mirëmbajtja sesa tek idetë e reja, do t'u bjerë pasioni dhe zjarri. Sepse kanë diçka që e trashëguan, por nuk kanë luftuar për të, e morën gati.

Brezi i tretë, fëmijët e tyre, do të shikojnë se sa shumë po e ruajnë dhe po kujdesen për ndërtesën dhe do të thonë, “*Sa ‘old’ janë këta. Sa të plakur në mendime janë këta*”. Nuk do të jetë dikush që do t'i frymëzojë për gjëra të reja dhe do të kërkojnë nxitje të reja nëpër botë. Dhe ajo që u bë me mund deri në këtë pikë, tani fillon e fiket. Nuk po them profeci (urojmë dhe besojmë që do të jetë ndryshe me ne), por e shikon këtë trend në shumë histori në Bibël. P.sh. Jozueu, komandanti lengjendar. Siç themi për Skënderbeun, Adem Jasharin, etj., në Bibël ke Jozueun.

Ai e drejtoi popullin drejt tokës së premtuar, në luftëra të mëdha, fitore të mëdha, rrisht të madh, por edhe në shpërblim shumë të madh.

Pas kësaj, brezi i dytë jetoi në tokën e trashëguar. Nuk bënë më beteja. Ata ‘zunë rehat,’ dhe po e adhuronin Zotin me vakësi. Po ruanin atë që fitoi brezi i parë.

Pastaj brezi i tretë e panë që këta po ruanin shtëpitë dhe tokat e tyre të trashëguara, por brezi i tretë donte aventurë, adrenalinë. Panë që prindërit e tyre po e adhuronin Zotin si me përtesë, si me gjysmë zemre dhe thanë: “*Po pse po e adhuroni, kur e bëni me përtesë? Pse vini në kishë sikur po ju çon njeri me zor? Pse e lexoni Biblën vetëm kur keni hall dhe ka zënë pluhur? Pse luteni vetëm për Krishtlindje ose shumë rrallë? Pse e bëni me zor dhe me përtim këtë gjë? Ju më mirë adhuroni diçka tjetër, sesa ta bëni me gjysmë zemre diçka.*”

Kështu që ata sajuan gjëra të reja dhe ikën fare nga adhurimi ndaj Perëndisë. Ja si thuhet për brezin e tretë:

**Gjyqtarët 21:25** “*Në atë kohë nuk kishte asnjë mbret në Izrael; secili bënte atë që i dukej e drejtë në sytë e tij.*”

Bënin çfarë t'u vinte atyre më për mbarë. Nga brezi i parë, pasionantë, që linin kokën pas Perëndisë dhe Fjalës së Tij, deri tek brezi i tretë, që po bënin si t'ua jepte mendja e tyre.

Nëse ne i bëjmë gjërat mirë dhe me pasion, por nuk i pasojmë ato vlera tek brezi tjetër, kjo gjë, kjo kishë, ky besim te Krishti Jezus, do të fiket në brezat e tjerë.

Nuk e ndjen, sepse vjen duke rënë gradualisht.

Ja të shikojmë tri gjëra ku po has vështirësi brezi i parë se si t'i pasojë siç duhet vlerat tek brezi tjetër. E sigurt që ka më shumë, por vetëm tri do të theksojmë sot. Nga dallohet që s'po trashëgojmë vlerat e duhura?

## 1 - Kur Nuk Po Rrezikojmë Më

Ja, ta shikojmë sa rrezikohet më parë dhe sa pak tani. Ngri dorën, nëse e ke bërë këtë gjë:

**Ngri dorën**, nëse shkoje me këmbë në shkollë!

Disa thonë “*Si mund të ecet me këmbë në pikë të mëngjesit?*”

*(Unë duhet të kaloja një lumë çdo ditë për të shkuar në shkollë edhe sa herë binte shi e hiqte urën dhe duhet të zhvisheshim për të hyrë në lumë.)*

**Ngri dorën**, nëse je rritur duke luajtur në oborr dhe s'ke patur telefon kur ishe fëmijë!

Disa thonë *“Çfarë, a mund të jetojë njeri pa telefon?”*

**Ngri dorën**, nëse vetëm vonë e ke marr vesh çfarë është rripi i sigurimit në makinë!

Në autobus, ishte mami rripi i sigurimit që të mbante në krahë dhe s'e gjente gjë fëmijën.

Madje kur frenonte makina, fëmija e rraste kokën te gjiri i mamit jastëk i butë! (Nga kjo lindi dhe ideja për “airbag-un”, jastëkun e ajrit) (shaka!)

*(Në fshatin tim, ne lëviznim me kamion, që quhet “IFA”, në karroceri, siç transportohen drutë sot.)*

Nuk po them, që duhet të kthehem ku kemi qenë, por tani po i ruajmë fëmijët nga çdo lloj rreziku.

**Madje ka ide:** *“Të hiqen disa gjëra te këndi i lojrave, se i bie koka te cepi fëmijës dhe vritet.”*

Po ne që hipnin 20 fëmijë në një pemë fiku dhe gjysmat rrëzoheshim nja 20 herë dhe e kemi kokën me të paktën dy-tre të çara?!

**Sot:** *“Mësuesi s'duhet të përdorë laps të kuq sepse e kuqja mund ta trembi fëmijën. Dhe të sigurohem që kur bëhet një lojë, jo vetëm fituesi të marrë medalje, por të gjithë marrin medalje ose certifikata për pjesëmarrje, se na mërzhiten të tjerët.”*

Atëherë, duhet të punoje fort për të marrë një lëvdatë, një meritë! Po e ruajmë brezin e dytë më shumë se ç'duhet edhe nga ca gjëra që u bëjnë mirë. Ca gjëra iu bëjnë mirë sepse i bëjnë më të fortë.

**Një profesor thoshte** se ka nxënës mature që kanë frikë të plotësojnë formularin e shkollës së lartë, se mos e plotësojnë gabim. Ose kanë frikë të shkojnë për intervistë pune, se mos i lëndon ndjenjat punëmarrësi nëse i thotë që s'e ka fituar punën.

Ose ka shumë që kanë marrë patentën dhe kanë frikë t'i japin makinës. Më mirë presin kur të vijë burri, gruaja që t'i japë makinës, por vetëm ai/ajo mos t'i japë, se është me shumë rrezik atje jashtë.

Ore, mos po ruhem një çikë si shumë dhe po rrisim një brez “qullo” që kur të bëhen prindër do të rrisin një brez akoma më “qullo”?

Tani, nuk po them që hajde “lajthisim nga trutë” se po na ikën jeta pa një çikë adrenalinë

*“Kështu që ta tymosim nga një degë jeshile, se i duhet robit të shohë me ngjyra të provojë ca gjera...”*

S'po them të shkojmë nga ekstremi në ekstrem, por duhet të ketë diçka të mesme.

Pra, ka gjasa se nga mënyra sesi u rritëm ne, po mundohemi që brezin tjetër të mos e lëmë të rrezikojë fare.

## 2 - I Ndhimojmë Shumë Shpejt

*“Nuk e ke bërë projektin te shkolla? Ke mamin ti, shkon mami me vrap te kancelaria e lagjes!”*

Blen ca gjëra dhe ia bën gati për nesër fëmijës, rri mami deri në njëmbëdhjetë të natës duke bërë projektin me kartona, pastelina, vetëm që *“fëmija im të mos jetë në siklet nesër”*.

Babi që merr leje nga puna sepse sot ka ditëlindjen shoqja e bankës së vajzës dhe duhet të jenë të gjithë prindërit te ditëlindja e shoqes.

*“Fëmija im ka harruar të marrë bukë me vete ose s'ka marrë lek me vete?”*

Merr mami leje nga puna, zihet mami një orë me shefin dhe shkon si “skifter” nga dritarja e shkollës me hamburger me patate, pepsi dhe gjëra të mira për *“zogun e vogël që desh vdiq nga uria, se ndenji një vakt pa bukë”*.

Në kohën tonë: “*S’ke ngrënë, po ku i pate trutë?*” Ta jepnin dhe një syve që ta mbaje mend mirë, mos ta harroje më.

Në atë kohë, goditjet me shapkë ishin “në modë”, që të mos vrisje dorën, ose çukitja e profesorit me çelës në kokë, kur s’kishe mësuar.

Nuk po them që duhen kthyer apo ishte gjë e mirë, por s’ta përtonte njeri, as në shtëpi, as në shkollë, as në fis.

Në ato vite, nëse kishe mbaruar ushtrinë ishe pjekur, nëse ishe 21 vjeç e lart ishe burrëruar për gjëra më të mëdha, punë ose martesë. Sot martesë po duket si diçka e frikshme, që ndodh kur s’ke çfarë bën më, kur s’e shtyn dot më gjatë, se me shpirt e lije fare si muhabet për nga 40 e ca vjeç.

Dhe shumica po rrinë akoma me mamin sepse është vështirë atje jashtë, te ha ujku!

Atëherë quheshe “çun mamaje”, nëse kishe mbaruar shkollën ose ushtrinë dhe ishe akoma me mamin.

Ndërsa tani quhet arritje nëse je akoma me mamin në shtëpi.

A e mban mend historinë e djalit plangprishës? Djali që iku nga shtëpia. Çfarë bëri i ati? Nuk e shpëtoi nga situata e vështirë. Nuk e mori në celular nja njëqind herë “*Ku je të keqen babi, a ke ngrënë, a ke blerë atlete të reja, ma trego një foto ça hëngre për drekë*”.

Babai e donte shumë, ia dha pjesën e pasurisë, por ai iku me vrap. I bëri “rrush e kumbulla.” Ai po jetonte në stallën e derrave. Ishte copë-copë. I ati e deshë aq shumë, sa që e la të zhgarravitej, të mësonte nga pasojat e zgjedhjeve të tij, që ai vetë t’i thërriste mendjes. Dhe thuhet: “*Kur i thirri mendjes, u kujtua. Çfarë po bëj, kush jam, ku kam përfunduar?*”

Ndryshe, nëse nuk ndodh ky proces, të gabojë, ta vuajë gabimin, të nxjerrë mësimin, nëse shkojmë dhe i ndihmojmë shpejt, nuk do nxjerrë mësimin e duhur.

Po e ruajmë më shumë se ç’duhet brezin e ri nga pasojat e gafave të tyre dhe po i paralizojmë sepse nuk po fuqizohen. Nesër, kur të përplasen me jetën e vërtetë, ata do kalojnë stresse dhe depresione të panevojshme. Sepse po i mbrojmë më shumë se ç’duhet.

Rrezikojmë më pak, i shpëtojmë më shpejt se ç’duhet. Po e treta cila është?

### 3 - I Shpërblejmë Shumë Shpejt

U japim gjëra “qyl”, gjëra për të cilat ata duhet të punojnë që t’i fitojnë vetë. U japim gjëra me dëshirën e mirë, por më e mira do ishte t’i fitonin ato gjëra vetë.

Përsëri do e ilustruj me diçka të ekzagjërues, por më kuptoni që dua të dal diku.

Fëmijëve që në kopësht u japim lek me vete, u blejmë nga një telefon më të madh se dora.

Vetëm atletet e tyre kushtojnë sa të gjitha rrobat e tua sepse “*ashtu janë të gjithë moshatarët e tyre*”.

Nuk shkon më njeri me rroba dosido në shkollë, duhen firmato, “brande”, telefona nga më të mirët dhe gjëra të gatshme gjithë kohës, pa pikë mundimi.

Nuk bëjnë më kalamanjtë asnjë punë shtëpie! Po s’bënë ndonjë punë shtëpie, për çfarë ua jep lekët?

“*Kot për qejf, një çun kam/ një gocë kam/ dy-tre fëmijë kam, nuk kam shumë.*”

Pa e kuptuar që po i trajnojmë me idenë se: Gjërat në jetë fitohen shumë kollaj. Dhe pastaj habitemi kur rriten e na thonë: “*Kam një si boshllëk, nuk më ngop asgjë, kam shumë gjëra, por prap nuk ndjej që kam gjë.*”

Po normale, ke ngrënë në kurriz të prindërve, nga munda i atyre që rrinë me netë pa gjumë. Pastaj këta të rinj marrin borxhe, kredi, fillojnë “hashashëra”, “viza”, pije, gjëra.... sepse duan të mbushin boshllëkun.

Ka kënaqësi kur punon, kur e fiton vetë diçka.

Në këto kohë po adhurojmë lumturinë dhe qejfin. Çfarë dëshiron ti?

*“Dua veç të jem i lumtur. Dua që fëmijet e mi të vegjël veç të jenë të lumtur. Dhe do të bëjmë çdo gjë që t’i mbajmë të lumtur. Do t’i ruajmë nga çdo gjë që mund t’i lëndojë ata. Veç ji i lumtur të keqen babi/mami.”*

Dhe ne premtojmë para Perëndisë që do të jemi me ty, në të mirë e në të keq, në pasuri dhe varfëri, derisa vdekja të na ndajë. Ne duam që të jesh i lumtur. Sepse vetë ka thënë Perëndia “*Ji i lumtur siç jam unë i lumtur.*” Apo nuk është kështu ai vargu në Biblël?

Më duket thotë: “**Jini Të Shenjtë Siç Unë Jam i Shenjtë.**” --Perëndia

Adhurojmë idhullin e lumturisë, ndërkohë që Perëndia do që të jemi të shenjtë, para se të jemi të lumtur.

Po vendosëm lumturinë të parën, do të thotë edhe se do ta paguajmë me çdo kusht.

*“Na duhen më shumë lek? Do të punojmë nga dy punë, veç të jemi të lumtur. Veç të më shkojë rroga mbi “500”, mbi “700”, mbi “1 milion”, po do shikosh ti sa i lumtur do jem!”*

Dhe kur arrin një nivel, je i lumtur ca muaj, pastaj prapë kthehesh po aty ku ishe.

*-Duhet të marthohem, prandaj s’jam shumë i lumtur.*

*-Duhet ta ndërroj gruan, duhet të ndahem se kam parë një më të mirë.*

*-Duhet të kemi këtë, jojo dhe atë...*

Dhe prapë s’je i lumtur.

**Lumturia është zgjedhje, nuk varet nga rrethanat.**

*-Po të kem më shumë ndjekës, po të kem “blue tick”, po të bëhet viral postimi im, po të kem më shumë shokë, një makinë...*

Nëse lumturia jote ka kushte, është lumturi e përkohshme. Na është bërë synim që të jemi të lumtur së pari.

Jojo! Së pari: **Le Të Nderojmë Perëndinë!**

Mos më keqkupto, sepse gëzimi, lumturia, shpresa, dashuria, janë produkte, janë fryte. Kur së pari jeton për lavdinë e Perëndisë, kur vendos Atë të parin, kur i shërben Atij, ka ngopje, ka kënaqësi, ka gëzim që zgjat.

POR, duhet ta kemi ne vetë si vlerë, pastaj t’ua përcjellim fëmijëve ato vlera: bujarinë, dhembshurinë dhe drejtësinë. Këto vijnë kur jeta jetohet e drejtuar nga Fryma e Perëndisë, jo çfarë bën shumica.

Sepse shiko, kur përdor atë që ke, për t’i shërbyer dikujt, ka gëzim në atë gjë. Pastaj vjen si produkt - ti bën për dikë, pastaj ndjen gëzim edhe ti.

**Si e mendon për vete dhe fëmijët e tu:** Së pari të jenë të lumtur, apo së pari të jenë të gatshëm për atë që do të përballen nesër?

### **Sepse Kur e Jep Jetën, Atëherë e Gjen.**

Kur jep nga jeta jote, duket si humbje, por e gjen sepse të jep plotësi, gëzim dhe kënaqësi kur bën për dikë.

**Dhembshuri** - kur kujdesesh për dikë. Po bëhet gjë e rrallë, sepse të gjithë e kanë mendjen tek vetja.

Një herë po predikoja, por me shumë pasion dhe po mendoja: *“Ky është mesazhi më i mirë që kam bërë ndonjëherë”*. Dhe e pyeta dikë: *“Si ishte mesazhi?”* *“Mirë, mirë, jo keq. Po për të ngrënë ka ndonjë vend këtu në lagje, a ka ndonjë suflaqe, se më ka shkuar ora e drekës,”* - m'u përgjigj.

Unë do të mundohem që t'ju nxis fort që të mendoni për të tjerët. Mendoni për veten, po pak më vonë, pasi keni bërë diçka për dikë, pastaj mendoni për veten tuaj.

Ka gëzim, ka kënaqësi kur bën për të tjerët.

**I drejtë** - kur jeton për të nderuar emrin e Perëndisë. Njerëzit do të tallen me ty, kur ti nuk bën kompromise, nuk kopjon ose nuk korruptohesh.

Po punë e madhe! Për shkak se ti e ke fiksuar në mendje *“Do të nderoj Perëndinë”*, nuk e ke problem kur has sfida. Sepse, duke nderuar Atë, Fryma e Shenjtë prodhon fryte brenda teje: gëzim, paqe, mirësi, mirëdashje, vetëkontroll.

Për ta përmbledhur në një fjalë do e thosha kështu:

*Ta kemi mendjen më shumë tek përgatitja për sfidat e jetës, sesa tek lumturia e momentit.*

Ta kemi mendjen më pak te *“Çfarë dhurate do t'u bëjmë kalamjave sot,”* dhe më shumë mendjen te *“Çfarë vlerash, mjetesh, po u japim për nesër,”* që të dinë të çajnë në jetë dhe ta nderojnë emrin e Zotit kudo që të jenë.

Ja të them disa hapa praktikë se si behet kjo gjë.

Prit pak, dua të nxis prindërit: A ju pëlqen se sa të mirë janë skuadra e studentëve dhe adoleshentëve?

Po sikur të ndihmoni ju vetë herë pas here?

Ta bëni me radhë. Nëse ke fëmijë të vegjël, një herë në dy muaj zgjidh për të ndihmuar në shërbesën e fëmijëve.

Nëse i ke adoleshentë, një herë në dy muaj zgjidh për të ndihmuar ose për të gatuar diçka për ta, ose diçka tjetër praktike. Le të ndihmojmë dhe ndikojmë brezin e ri me çdo lloj forme.

Nëse e ke përjetuar dashurinë dhe hirin e Perëndisë, përse të mos bësh diçka me jetën tënde për fëmijët ose për adoleshentet?

Të bëheni bashkë si prindër që keni fëmijët adoleshentë dhe të takoheni një herë në kaq kohë, kot për qejf, për të folur për sfidat që keni dhe si ta ndihmoni njëri-tjetrin.

Se disa herë, kur fëmijëve ose adoleshentëve u jep këshillë një tjetër i rritur, për çudi ata ua vënë veshin më shumë atyre.

E di çfarë kam ëndërr? Që do të duhet të zësh radhën për të shërbyer një ditë tek fëmijët dhe adoleshentët. Sepse aq shumë doni ta ndikoni jetën e një fëmije dhe adoleshenti.

Imagjino sikur vetëm një çift të shërbejë çdo të diel, të bie radha një herë në 3-4 muaj.

Si ta ndihmojmë brezin e ri? Ja të jap ca ide se për çfarë do të flasim në javët në vazhdim:

*Javën tjetër:*

### **Si Të Krijojmë Pasuri Për Lavdinë e Perëndisë.**

Sepse, a thoshte vargu “do të kenë bollëk dhe pasuri”?

Ka njerëz që thonë: “Të pasurit janë të këqinj. Ai që është i pasur kushedi sesi i ka bërë lekët, ka shtypur dikë, ka abuzuar me dikë.”

Jo gjithmonë, por kam patur rastin të takoj njerëz të pasur, shumë punëtorë dhe çdo gjë e kanë arritur me punë. Asnjëri nuk është shqiptar nga këta. Në fakt nuk njoh gati asnjë shqiptar që e kam të njohur dhe ka shumë lek.

Mendoj që s’është problemi me pasurinë. Problemi më i madh është me dashurinë e thellë për lekun. Paraja është mjet fantastik, por është zot shumë i keq. Të deformon karakterin, të shtyn të bësh gjëra që nuk do t’i bëje kurrë.

Si ndjekës i Krishtit, përdore paranë si mjet.

*Njerëzit duan lekun dhe përdorin njerëzit. Ne, le të duam njerëzit dhe të përdorim lekët për të ndikuar dikë, për të ndihmuar dikë.*

Në kohë të tilla, ka shumë tranzicion sepse me gjithë mend po rriten rrogat ca, por janë rritur dhe shumë gjëra të tjera. Si ta përdorësh lekun si mjet? Një nga gjërat e frikshme këtë kohë është se njerëzit po hyjnë në borxh shumë kollaj, me kredi, nëpër miq, nëpër shokë.

Po për çfarë, për të blerë një shtëpi, për të filluar një biznes apo për qejf? Është shumë stres, të marrësh borxhe dhe të punosh vetëm si e si t’i shlyesh ato.

Dua shumë të shikojmë disa parime sipas Shkrimit në lidhje me financat.

*Java e tretë:*

### **Si Të Krijojmë Uri Besimi Siç e Kishte Brezi i Parë**

Nëse je besimtar i ri, e ke parasysh atë besimin plot pasion të fillimit? Duam që edhe brezi i dytë të ketë atë lloj besimi të çiltër, të pastër, të zjarrtë dhe të kenë dëshmi si ato të brezit të parë.

**Të thonë:** “*U luta, Perëndia u përgjigj. Plotësoi nevojën time, më ndryshoi jetën time. Po lexoja Biblën dhe ja se si më foli Perëndia*”.

Dëshmitë si të brezit të parë, janë ato që sjellin ndikim.

*Java e katërt:*

Do t’ju nxis që t’i duam shumë të rinjtë dhe t’u rrimë afër atyre. Sepse janë të mirë dhe janë plot pasion, ne të jemi aty për t’i fuqizuar, t’u japim mjetet e duhura dhe t’u themi: “*Ti mund të bësh më shumë gjëra akoma edhe më të mira se ç’bëra unë!*”

### **Të Krijojmë: Një Pasion Dhe Dëshirë Për Gjërat Që Zgjasin Përjetë.**

Pastaj duam që të rinjtë të shikojnë nevojat rreth e qark tyre dhe të shikojnë si mund të bëjnë diçka. Ta shikojnë botën me sytë e Jezusit.

Ja se çfarë tha Davidi për djalin e tij, Solomonin:

**1 Kronikave 28:9** “*Ti Salomon, biri im njihe Perëndinë e atit tënd dhe shërbeji me gjithë zemër dhe me shpirt e vullnet të mirë, sepse Zoti heton të gjitha zemrat dhe kupton tërë qëllimet e*



o

*mendimeve. Në rast se ti e kërkon, ai do të të lërë ta gjesh; por në rast se ti e braktis, ai do të të hedhë poshtë përjetë.”*

Babai po i flet të birit, brezi i parë po i flet brezit të dytë. Ti ke për të bërë më shumë se unë. Unë s’do të të ndihmoj, unë do të të kujtoj: “*Kërko Perëndinë. Njihe Atë.*” Bëj atë për të cilën të ka thirrur. Ji i fortë. Bëj më shumë nga sa ç’bëra unë për lavdinë e Tij. Kjo është trashëgimia që po të lë. Dua të të lë atë që kam besuar dhe uroj dhe besoj që të bësh më shumë se ç’bëra unë.

Filloni diçka si familje: Lexoni Biblën bashkë, fillojeni ditën duke u lutur bashkë. Shkarkoje Biblën “YouVersion”, te celulari i fëmijës ka dhe një version për fëmijë të vegjël. Bëni një plan 30 ditë për të lexuar Biblën bashkë me burrin, gruan, si familje.

**Le të lutemi!**